

Hoxha: Më 1 tetor fillojnë studimet në Universitetin e Prizrenit

Edhe pse ende pa objekt të vetin, ministri Hoxha ka thënë se “më 1 tetor të këtij viti Kosova do ta ketë edhe Universitetin e Prizrenit, i cili do t’u ofrojë studentëve mundësinë e studimeve edhe në 15 fusha të reja dhe gjithashtu viti i parë i studimeve në këtë universitet do të jetë pa pagesë”

KOHA

ARMEND ATASHI

PRISHTINË, 21 SHKURT – Univesiteti Publik i Prizrenit pritet të fillojë procesin e rregullt të punës më 1 tetor të këtij viti, por jo në godinën e re, sikurse që është thënë më herët, por në objektin ku aktualisht funksionon Fakulteti i Edukimit. Kjo është thënë të dielën nga vetë ministri i Arsimit në Qeverinë e Kosovës, Enver Hoxha, gjatë një konference për media së bashku me ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Walter Maria Stojan. Gjatë kësaj konference ministri ka njoftuar të ketë nënshkruar marrëveshje për partneritet me ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Walter Maria Stojan. Epiqendër e kësaj marrëveshjeje është thënë të jetë themelimi dhe funksionalizimi i Universitetit të Prizrenit. Ministri Hoxhaj ka thënë se më 1 tetor të këtij viti Kosova do të ketë edhe Universitetin e Prizrenit, i cili do t’u ofrojë studentëve mundësinë e studimeve edhe në 15 fusha të reja të studimeve dhe gjithashtu, sipas ministrit të MASHT it, viti i parë i studimeve në këtë univer-

sitet do të jetë pa pagesë. “Republika e Kosovës dhe Republika e Austrisë do të kenë partneritet institucional në themelimin dhe funksionalizimin e Universitetit të Prizrenit, partneritet i cili do të mbështetet përmes projekteve të ndryshme, si mbështetje financiare etj.”, ka thënë Enver Hoxhaj, ministër i Arsimit. Ambasadori Austriak në Kosovë, Walter Maria Stojan, ka thënë se bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Austrisë të ketë një traditë të gjatë qysh nga vitet nëntëdhjetë, kur shumë studentë nga Kosova kanë shkruar në Austri për të studiuar, ndërsa në shekullin XXI Austria të ketë filluar përkrahjen e arsimit të lartë në Kosovë. “Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Arsimit në Kosovë ka qenë e mundur që të krijohet një partneritet institucional në mes të Austrisë dhe Kosovës. Së fundmi, në kuadër të këtij bashkëpunimi Austria e përkrah fuqishëm themelimin e Universitetit të dytë publik të Universitetit të Prizrenit”, ka thënë ambasadori Stojan. Ministri Hoxhaj ka bërë të ditur

se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet për ndërtimin e këtij universiteti dhe se është ndarë buxheti prej 3 milionë euro, si dhe lokacioni rreth 20 hektarë, por nuk ka treguar se kur do të ndërtohet ky objekt. “Në fillim, më 1 tetor, ne do të startojmë në objektin e Fakultetit të Edukimit, pastaj do të shohim mundësinë e ndërtimit të kampusit për këtë universitet”, ka deklaruar Hoxhaj. Më tutje ministri ka sqaruar se gjatë këtij viti përgatitjet e para do të jenë në zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Prizrenit dhe tashmë që disa javë është shpallur konkursi, ndërkaq në javën e ardhshme hapet konkursi edhe për stafin e ri për Universitetin e Prizrenit. “Do të ofrojmë programe studimore që nuk ofron UP-ja, kemi punuar që të arrijmë mbështetjen e vendeve perëndimore që në themelimin e tij ky universitet të jetë universitet i shekullit XXI”, ka thënë ai. Studentët në Universitetin e Prizrenit do të ndjekin 15 fusha të studimeve: fusha ekonomike, teknologjia e informacionit, ekonomia dhe matematika, menaxhmenti dhe teknologjia, juridiku, juridiku dhe ekonomia,

tregtia dhe turizmi, ambienti dhe zhvillimi rajonal, gjuha angleze, gjuha gjermane, shkencat e përkthimit, studimet kulturore, studimet e mediave, ka bërë të ditur Hoxhaj. Ambasadori austriak, Stojan, ka njoftuar se në fund të vitit të kaluar ministri i Arsimit të Austrisë të ketë caktuar dy konsulentë, profesorë austriakë, të cilët do të përkrahin në hartimin e statutit të përkohshëm, por edhe në përzgjedhjen e rektorit. “Me nisjen e këtyre hapave të rëndësishëm ne do të jemi në gjendje që ta caktojmë kornizën e Universitetit të Prizrenit. Edhe përmes WUS-Austria ne do të ndihmojmë në zhvillimin e kurrikulave dhe themelimin e departamenteve”, ka thënë më tutje ai. Në fund ministri Hoxhaj u ka bërë thirrje kuadrove në SHBA dhe në shtete të Evropës që të aplikojnë dhe të bëjnë karrierë në Universitetin e Prizrenit. Hoxhaj ka njoftuar se në vazhdimësi angazhimeve të tij për arritjen e marrëveshjeve për funksionalizimin e Universitetit të Prizrenit javën e ardhshme do të takohet edhe me ministrin e Arsimit të Gjermanisë.

22/02/2010, "KOHA DITORE"